



Pyetje dhe përgjigje të shpeshta lidhur me vendimin Nr. 9/2020 të KQZ-së

1. A mund të zhvillohet një procedurë për dhënie me qira/kontratë të aseteve të paluajtshme?

Çdo veprimtari e administratës publike, sipas fushës së veprimtarisë shtetërore, lejohet të ushtrohet sipas akteve ligjore dhe dokumenteve në fuqi. Të ndaluara janë vetëm ato veprimtari, që asetet publike të luajtshme dhe të paluajtshme në pronësi apo administrim të organeve/enteve shtetërore, i vendosin në dispozicion për qëllime zgjedhore.

Në çdo rast, institucioni duhet të vlerësojë vetë nëse veprimtaria është për qëllime zgjedhore.

2. Kam filluar një procedurë koncensionit, a me lejohet ta vazhdojë atë?

Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve, ndalohet dhënia e kontratave publike të koncensionit/partneritet publik privat (PPP), për të cilat nuk është bërë njoftim publik se do të zhvillohen, nuk janë vijim i një procedure koncensionare të identifikuar dhe nisur, apo nuk janë parashikuar për t'u financuar nëpërmjet buxhetit të shtetit të miratuar në vitin zgjedhor. Për t'u qartësuar nëse procedura koncesionare është njoftuar, identifikuar dhe nisur përpara apo pas periudhës së ndalimit duhet të konsultoheni me legjislacionin përkatës sektorial.

3. Një institucion qendror në planin vjetor ka parashikuar ristrukturim të tij, ku parashikohen pranime apo largime nga puna. Konsiderohet kjo një veprimtari e ndaluar 4 muaj para datës së zgjedhjeve?

Vetëm gjatë fushatës zgjedhore, ndalohet marrja në punë, pushimi nga puna, lirimi, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucionet apo entet publike, shtesat ne organiken e cdo institucioni publik e shtetëror apo emërimet provizore, me përjashtim të rasteve të përligjura.

Konsiderohen raste të përligjura vetëm ato raste kur lëvizja apo lirimi nga puna vjen si rrjedhojë e shkeljeve, sipas legjislacionit përkatës, ose marrja në punë bëhet brenda strukturës dhe organikës në fuqi në përmbushje të misionit të tij. Bëjnë përjashtim rastet e emergjencave për shkak të ngjarjeve të paparashikuara që diktojnë marrjen në punë.

4. A mund të kryhen inspektime për projekte strategjike/ investime apo të zhvillohen vizita në shtëpi që janë rindërtuar apo janë në proces rindërtimi për shkak të fatkeqësisë natyrore?

Aktiviteti është i ndaluar të promovohet vetëm në rast se investimi që promovohet është realizuar apo është në proces realizimi me fonde të vëna rishtazi, apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar jo sipas planit buxhetor të miratuar 4 muaj para datës së zgjedhjeve. Kjo mund të ndodhë vetëm nëse fondet për këto projekte kanë nisur përpara periudhës së ndalimit me ligj të parashikuara në Kodin Zgjedhor, që përfshin periudhën 4-mujore

5. A mund të merret leje paraprakisht në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për një veprimtari të caktuar?

KQZ nuk shprehet paraprakisht për raste individuale apo kërkesa specifike të institucioneve. Institucionet publike, qendrore/vendore e të varësisë, raportojnë në ndërfaqen e dedikuar në faqen zyrtare elektronike kqz.gov.al, veprimtaritë publike të planifikuara për t'u promovuar.

